

NEWSLETTER

Publikim i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Qershor 2018



EVENTE

- **UI Forum 2018, mbi 120 CEO dhe kryetarë bordesh nga Europa vijnë në Shqipëri**
- **Në kuadër të 20-vjetorit, SIGAL UNIQA sjell risinë për klientët**
- **Shoqata e siguruesve slllovene takim në Tiranë me kompanitë shqiptare të sigurimeve**

Marketing&Pergjegjesi sociale

- **Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA në Pogradec dhe Buçimas**

TREGU I SIGURIMEVE

- **Të dhënat nga AMF për periudhën janar-maj 2018, SIGAL UNIQA udhëheq tregun**

EVENTE



UI Forum 2018, mbi 120 CEO dhe kryetarë bordesh nga Europa vijnë në Shqipëri

Nën sloganin ‘Mendo që idetë e mëdha ndriçojnë rrugën’, u mbajt Forumi Ndërkombëtar Ekonomik “UNIQA International Forum 2018”, i cili zhvilloi punimet nga datat 4-8 qershor 2018 në Tiranë. Me ftesë të SIGAL UNIQA Albania dhe nën kujdesin e veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Avni Ponari, mbi 120 CEO dhe Kryetarë të Bordeve Drejtuese të kompanive UNIQA Insurance Group nga 16 shtete Europiane u mbledhën në Tiranë për të diskutuar mbi mbarëvajtjen, objektivat dhe synimet e grupit UNIQA në të gjithë shtetet ku gjigandi europian i sigurimeve operon, përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet SIGAL UNIQA Group Austria. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj u uroi mirëseardhjen të ftuarëve në Tiranë, dhe duke folur për potencialin e jashtëzakonshëm që ka Tirana dhe e gjithë Shqipëria, gjithashtu u ndal në rolin që ka luajtur SIGAL UNIQA në zhvillimin ekonomik dhe përgjegjësinë sociale të Tiranës dhe më gjerë. Në përfundim të forumit Z. Ponari, si pritës i mysafirëve europianë, i ftoi ata që të vizitojnë sërish bukuritë e rralla të Shqipërisë.

Në kuadër të 20-vjetorit, SIGAL UNIQA sjell risinë për klientët

Në Hollin Protokollar të Kryeministritë u mbajt konferenca për mediat e SIGAL UNIQA Group Austria, ku merrnin pjesë Zv. Kryeministria e Shqipërisë Znj. Senida Mesi, Z. Andreas Brandstetter CEO i UNIQA Insurance Group, Z. Avni Ponari-CEO i SIGAL UNIQA për Shqipërinë-Kosovën dhe Maqedoninë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Z. Arben Ahmetaj, Ministra e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Znj. Sonila Qato, Zv.Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Z. Elton Haxhi, Zv. Ministria e Punëve të Jashtme, Znj. Kleopatra Maliqi, Nën-Kryetaria e AMF-së Znj. Mimoza Kaçi, ministra dhe përfaqësuesë të tjerë të qeverisë, përfaqësuesë të institucioneve financiare dhe diplomatike në Shqipëri, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, Z. Johann Sattler etj.

Boshti i takimit me mediat dhe përfaqësuesit e biznesit dhe të qeverisë sot ishte risitë që kompania SIGAL UNIQA sjell për qytetarët nëpërmjet dixhitalizimit dhe inovacionit. SIGAL UNIQA është e para kompani në Shqipëri që futi shitjen online të sigurimeve. Sot ajo numëron 8 produkte sigurimesh online.

Së fundmi, SIGAL UNIQA ka dalë me aplikacionin e ri online të dedikuar për sigurimet, ku qytetarët jo vetëm mund të marrin të gjitha informacionet që ju duhen për sigurimet dhe të blejnë online sigurimin që ju duhet, por në kohë reale mund të aplikojnë për dëmshpërblimin. Zv.Kryeministria Mesi e vlerësoi kompaninë SIGAL UNIQA si kompani novatore dhe me produkte me cilësi europiane që i shërben klientëve dhe të gjithë tregut më së miri. Ajo gjithashtu tha se qeveria po shikon që ligji i ri ku parashikohet edhe funksionimi i sistemit Bonus-Malus të vihet në jetë.

SIGAL UNIQA, në kuadër të 20-vjetorit të themelimit të saj, organizoi nga datat 4-8 qershor 2018, të parin Forum Ndërkombëtar të Industrisë së Sigurimeve në Shqipëri, me pjesëmarrjen e mbi 120 CEO dhe Kryetarët e Bordeve Drejtuese të kompanive UNIQA Insurance Group nga 16 shtete Europiane.

Shoqata e Siguruesve të Sllovenisë takim në Tiranë me kompanitë e sigurimeve shqiptare

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë në bashkëpunim me kompanitë e sigurimeve sollën në Shqipëri përfaqësuesë të Shoqatës së Siguruesve Sllovene, Fondin e Kompensimit dhe Byronë e Sigurimeve Sllovene, për të shkëmbyer eksperiencat dhe diskutuar mbi potencialet e zhvillimit të sigurimeve në Shqipëri dhe gjithë rajonin. Fokusi i diskutimit ishte siguri i shtëpisë, sigurimet e bujqësisë dhe turizimit.

Në fund të takimit përfaqësuesit e Shoqatës Sllovene shkëmbyen eksperiencat me përfaqësuesit e kompanive shqiptare të sigurimit si dhe nënshkruan një kontratë bashkëpunimi me shoqatën e siguruesve të Shqipërisë, për të intensifikuar bashkëpunimet në të ardhmen.

Marketing & Përgjegjësi Sociale



Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA në Pogradec dhe Buçimas

Këtë radhë Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA ishte në qytetin e Pogradecit dhe në fshatin Buçimas të këtij qyteti, ku dhjetëra banorë morën falas shërbime shëndetësore nga klinika SIGAL.

Mjekët më të mirë specialistë të SIGAL UNIQA VitalTruck mirëpritën banorët për një sërë ekzaminimesh, duke filluar nga vizita dhe konsulta me mjekun patolog, matje e sheqerit në gjak, vizitë sysh e ORL, Elektrokardiograma e zemrës, Echo abdominale, Echo e indeve të buta, Echo e artikulacioneve, matje e kapacitetit vital të mushkërive, matje e oksigjenit në gjak me spirometër etj.

Klinika lëvizëse SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është e para dhe e vetmja klinikë e këtij lloji në Shqipëri. Duke mundësuar ekzaminime të ndryshme mjekësore në të gjithë vendin, përfshirë zonat rurale, SIGAL UNIQA synon promovimin e shëndetit të mirë duke nxitur njerëzit për kontrollë shëndetësore rutinë, nëpërmjet të cilave diagnostikohen sëmundje të ndryshme, trajtimi i të cilave është më i lehtë nëse kurohen në kohën e duhur.

TREGU I SIGURIMEVE

Të dhënat nga AMF, janar-maj, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për muajin janar-maj 2018, SIGAL UNIQA vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

65.03% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;

27.00 % të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës

21.90% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;

43.66% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;

29.13% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit

33.19% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

44.64% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Përgjegjësive Civile

46.40% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Garancive

Sipas AMF, tregu rezulton me një rritje prej 3.01% më shumë se në janar—maj 2017. Primet bruto kapën shifrën mbi 6,277 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 462,260 me një rritje prej 7.30% krahasuar me janar-maj 2017.

Për më shumë informacion kontaktoni: internal@sigal.com.al

©SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. 2018

